



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**Në çështjen juridike të :**

**AC-I-22-0235-A0001**

*Paditësi*

**E Z**, fshati K, Kamenicë

**Kundër:**

*E paditura/Ankuesja*

**N.SH. XIQ “Karaqeva”**, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2324, të datës 21 mars 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2324, i datës 21 mars 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 3 prill 2014, paditësi kishte parashtruar një kërkesë për rishikim të vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI045-0136 të datës 5 mars 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për 3 paga të papaguara në shumën prej 900.00 euro për periudhën nga maj-korrik 2006, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit, përkatësisht nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar.

Në kërkesë theksohet se AKM me anë të një njoftimi të datës 15 gusht 2006 i kishte njoftuar punëtorët e N.SH-së se punësimi i tyre përfundon menjëherë dhe në këtë njoftim theksohej se *“Shumat Pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit mbesin përgjegjësi e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontraktoheni kur të fillojnë këto procedura”*, Andaj, paditësi konsideron se me këtë përshkrim AKM i kishte lënë në pritje që kërkesat e tyre të shqyrtohen në procedurë të likuidimit. Prandaj, paditësi i kishte propozuar gjykatës që të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit dhe të bëhet e mundur pagesa e pagave, pasi që AKM me njoftimin e 15 gusht 2006 i kishte vënë të gjithë punëtorët në lajthitje pa fajin e tyre. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) me nr. GJI045-0136 të datës 5 mars 2014, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 15 gusht 2006, një kërkesë e punëtorëve të N.SH për AKP për regjistrin e fundit të pagave të papaguara për punëtor për periudhën prill-maj 2006, listat e pagesave për punëtorët për muajt mars, prill dhe maj të vitit 2006 dhe listë pagesën për vitin 2005.

Me datë 27 korrik 2021, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën thekson se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2. të Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon se ankesat e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, theksohet se kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Pra më së voni 3 vite nga maj 2006. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë, e paditura i

kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar, ndërsa të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 21 mars 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-2324 kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit, duke ndryshuar kështu vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI045-0136 të datës 5 mars 2014, ashtu që kishte obliguar të paditurën që ankuesit t'i paguaj shumën prej 430.95 euro, ndërsa pjesën e mbetur të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i ndërmarrjes në fjalë, por kontestuese është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit. Ankuesi bazën e kërkesës së tij e mbështetë në njoftimin e datës 15 gusht 2006 dhe listat e pagave të paguara të muajve paraprak dhe atë mars, prill dhe maj 2006 si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë, andaj gjykata e pranon si prova relevante këtë njoftim për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i N.SH-së në kohën e privatizimit të saj. Nga njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 15 gusht 2006, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune në N.SH deri më 15 gusht 2006, kohë kjo kur u privatizua N.SH-ja. Ndërsa, nga listë pagesat vjetore për muajin maj, qershor dhe korrik të vitit 2006 në shumën prej 143.13 euro dhe duke iu referuar kërkesës së ankuesit, N.SH nuk i ka paguat paditësit pagat për tre muaj që do të thotë se N.SH i ka mbetur borxh ankuesit shumën prej 430.95 euro. E paditura në rastin konkret nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të N.SH-së. Gjykata kishte vlerësuar edhe pretendimet tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Sa i përket pjesës tjetër e cila nuk është aprovuar, gjykata konsideron se e njëjta nuk është e mbështetur në provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë është refuzuar si e pabazuar.

Me datë 26 prill 2022, AKP-ja kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-2324 të datës 21 mars. 2022, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar duke refuzuar ankesën ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit si të pabazuar dhe duke vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje të ndryshme nga njëra tjetra.

Autoriteti i Likuidimit nuk e ka mohuar faktin se ndërprerja e marrëdhënie së punës së parashtruesit i është ndërprerë për shkak të privatizimit dhe gjithashtu ka sqaruar qartë se janë dy afate të ndryshme të parashkrimit që Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon drejtë ligjin. Afati i parë është “Afati për parashtrim të kërkesave” që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi e ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat një kreditor duhet t'i përmbushë në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet, e në rast të dështimit të përmbushjes së tyre, kërkesa e tij do të refuzohet. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i zbatoj ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI045-0136 të datës 5 mars 2014 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 14 janar 2022.

Paditësi e kishte pranuar ankesën e të paditurës me datë 6 tetor 2023, mirëpo nuk kishte paraqitur përgjigje.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për 3 paga të papaguara në shumën prej 900.00 euro për periudhën maj-korrik 2006, ishte refuzuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit me

arsyetimin se afati kohor kur paditësi kishte parashtruar kërkesën e tij për realizimin e së drejtës së tij të pretenduar, e njëjta ishte parashkruar.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur si prova: njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit, të datës 15 gusht 2006 si dhe listat e pagave të papaguara nga N.SH XIQ “Karaqeva”.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të 3 pagave të papaguara në shumën prej 430.95 euro për periudhën nga maj-qershor 2006 në shumën prej 430.95 euro ndërsa pjesën e mbetur përtej shumës së aprovuar e kishte refuzuar si të pabazuar.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit i datës 15 gusht 2006, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra në datën e lartcekur. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*. Andaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit të lartcekur kishte dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar ligjor në shumën e cekur më lartë.

Gjithashtu, duke u bazuar në listat e pagave për muajt maj, qershor dhe korrik të vitit 2006 shihet që paditësi e ka pas rrogën mujore 143.13 euro, që do të thotë se të njëjtit N.SH i ka mbetur borxh për periudhën e lartcekur shumën e përgjithshme prej 430.95 euro, e cila shumë do t’i paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit pajtohet edhe me vlerësimin e shkallës së parë lidhur me refuzimin e kërkesës së paditësit përtej shumës së aprovuar, pasi që duke u bazuar në shkresa të lëndës shihet që shuma e mbetur nuk është e mbështetur në prova apo dëshmi.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësi nuk kishte ofruar shërbime punë për N.SH apo se nuk i takon kompensimi i pretenduar.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim të 3 pagave të fundit të papaguara në shumën prej 430.95 euro për periudhën maj-korrik 2006.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 30 prill 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_